



Qendrat për punë sociale:

Qendra komunale për punë sociale – Shkup:

02/3297703, 02/3297700

Qps Kavardarci: 043/414102

Qps Pehçevë: 033/471072

Qps Strugë: 046/780783

Të gjitha informata shtesë për të drejtat e juaja dhe mënyrën si të mbroheni nga dhuna në familje mund t'i merrni në këta **SOS telefona:**

- 070 141 700
- 075 141 700
- 077 141 700



Ky informim u punua në suaza të projektit “Me përpjekje të përbashkëta – Drejt standardeve të reja evropiane për mbrojtjen e grave nga dhuna e bazuar në gjini” (Potpisuvam.org) të cilin e realizojnë Qendra femërore (Serbi), Këshilli nacional për barazi gjinore (Maqedoni) Qendra për gra viktime të luftës (Kroaci), Fondacioni gratë e bashkuara (Bosnja dhe Hercegovina), Shoqata SOS telefon (Slloveni), dhe Rrjeti evropian i femrave kundër dhunës (Austri) në bashkëpunim me Lobin evropian të grave.

Në Maqedoni ky projekt u realizua në bashkëpunim me organizatat lokale si Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut dhe LGBTI qendra për mbështetje, Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Organizata e grave „Vizion“ nga Kavardarci, Organizata e grave në Pehçevë dhe Shoqata për mundësi të barabarta „Ezerka“ nga Struga.



Informata është përgaditur me mbështetjen e Unionit Evropian.

Përmbajtja e informatës është përgjegjësi e autorëve dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk i reflekton qëndrimet e Unionit Evropian.

Kompetencat dhe veprimet e Qendrës për çështje sociale në raste të dhunës në familje



Dhunë në familje është kur një ose më shumë anëtarë të familjes ju kërcenohen ose ju lëndojnë:

- Ju shtyjnë, ose ju godasin me shuplakë, ju rrahin, ose në çfarëdo mënyrë tjetër ju lëndojnë;
- Ju maltreton, ju nënçmon, ju lëndon ose të drejtohet me fjalë ofenduese;
- Nuk ju lejon të lëvizni lirshëm ose ua ndalon kontaktet me anëtarët e familjes dhe miqtë;
- Nuk ju lejon të punoni dhe të fitoni, ose paratë që i keni fituar ua merr, ose ju detyron të punoni punë të cilat ju nuk i doni;
- Nuk ju jep dihmë dhe nuk ju mbron juve dhe anëtarët tjerë të familjes;

Institucionet e para nga të cilat mund të kërkonti ndihmë dhe mbrojtje janë: **Qendra për punë sociale dhe Policia.**

Në Qendrën për punë sociale:

- Bisedoni me punëtorin/punëtoren për çështje sociale, për atë që ju ka ndodhur dhe kërkoni të bëhet procesverbal;
- Kërkoni që nga personi profesional të njiheni me të drejtat e juaja ,të cilat ua garanton ligji dhe i njëjti t'ju ndihmojë që ato t'i realizoni;
- QPS ka për detyrë t'ju njoftojë edhe me mundësinë e vendosjes së juaj në strehimore për viktime të dhunës në familje, me mundësi edhe për përkujdesje;
- QPS ka për detyrë t'ju informojë për mundësinë e shfrytëzimit të mbështetjes juridike pa pagesë;
- QPS ka për detyrë t'ju mundësojë ndihmë psiko-sociale;
- Punëtori/punëtorja sociale ka për detyrë të bisedojë me ju për parashtrimin e kërkesës për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje deri te organet kompetente.

Nëse Qendra për punë sociale nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore atëherë ju keni mundësi:

- T'i drejtoheni drejtorit / drejtoreshës së QPS dhe me shkrim të jep arsyetim për sjelljen e atillë (menjëherë pas thyerjes së drejtës së juaj)
- T'i drejtoheni Ministrisë për punë dhe politikë sociale
- Të kërkonte ndihmë nga organizata joqeveritare. Sidomos nga ato të cilat sigurojnë ndihmë gratis
- Të parashtroni çështje gjyqësore ose akt padi.

